



PROPOZIM

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 40, paragrafi 40.2, pika **c** të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më .2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R

RRITJEN E MJETEVE NGA TEJKALIMI I PLANIT PËR TË HYRA VETJAKE DHE BARTJEN E MJETEVE NGA VITI 2025 NË VITIN 2026

- MIRATOHET** - Vendimi për rritjen e mjeteve nga tejkalimi i planit të të hyrave vetjake dhe bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026.
- Sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet rritja e tejkalimit të planit të të hyrave vetjake dhe bartjen e mjeteve nga vitit 2025 në vitin 2026, në vlerë prej **10,811,713.15 €**.
- Mjetet nga të hyrave vetjake nga viti 2025, do të destinohen në kategoritë për:

3.1. <i>paga dhe shtesa – 110</i>	60,000.00 €;
3.2. <i>mallra dhe shërbime – 130</i>	6,560,208.88 €;
3.3. <i>investime kapitale – 300</i>	4,191,504.27 €;

Gjithsej: 10,811,713.15 €

3.1. Paga dhe shtesa – vlera totale sipas nënprogramit 60,000.00 €

3.1.1 Arsimi i mesëm i lartë – 94350 në vlerë prej 60,000.00 €,

3.2. Mallra dhe shërbime – vlera totale sipas nënprogrameve 6,560,208.88 €

- 3.2.1 Administrata – 16306 në vlerë prej 674,044.11 €,
- 3.2.2 Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave – 18040 në vlerë prej 150,000.00 €,
- 3.2.3 Infrastruktura publike – 18166 në vlerë prej 4,298,924.07 €,
- 3.2.3 Shërbimet e shëndetësisë primare – 73350 në vlerë prej 243,000.00 €,
- 3.2.4 Shërbimet sociale – 75526 në vlerë prej 226,901.81 €,
- 3.2.5 Arsimi parashkollor – 92310 në vlerë prej 967,338.89 €,

3.3. Investimet kapitale – vlera totale sipas nënprogrameve 4,191,504.27 €

- 3.2.1. Administrata - 16306 në vlerë prej 169,000.00 €,
- 3.2.2. Shërbimet publike – 18039 në vlerë prej 74,462.50 €,
- 3.2.3. Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave – 18040 në vlerë prej 2,452,981.77 €,

- 3.2.4. Infrastruktura publike – 18166 në vlerë prej 710,000.00 €,
- 3.2.10. Sporti dhe rekreacioni – 85086 në vlerë prej 285,060.00 €,
- 3.2.12. Arsimi fillor, i mesëm i ulët – 93150 në vlerë prej 500,000.00 €,

- 4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelare.
- 5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.
- 6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

A r s y e t i m

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësive dhe Ligjin mbi buxhetin, nr. 10/L-001, neni 8, pika 7, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Tejkalimi i planit për të hyra vetjake përfshinë vlerën e mbledhur mbi planin buxhetor dhe bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026, dedikimi i këtyre mjeteve sipas kategorive do të jetë;

- Kategorija e pagave dhe shtesave, kompensimin e mësimi joformal për shkollat profesionale për vitet 2025 - 2026, obligime të papaguara, në vlerë prej 60,000.00 €, gjithsej kategorija e pagave dhe shtesave 60,000.00 €;
- Kategorija e mallrave dhe e shërbimeve, janë obligime ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë krijuar shkaku i aprovimit të vonshëm të buxhetit të vitit 2025 nga ana e Komunës së Prishtinës dhe në mungesë të komisionit për buxhet dhe financa në Kuvendin e Kosovës për aprovimin e buxhetit të rregullt për vitin 2025 për Komunën e Prishtinës, obligime në vlerë prej 6,560,208.88 €;
- Kategorija e investimeve kapitale, janë obligime të mbetura ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë krijuar shkaku i aprovimit të vonshëm të buxhetit të vitit 2025 nga ana e Komunës së Prishtinës dhe në mungesë të komisionit për buxhet dhe financa në Kuvendin e Kosovës për aprovimin e buxhetit të rregullt për vitin 2025 për Komunën e Prishtinës, obligime në vlerë prej 4,191,504.27 €.

Të bashkëngjitura janë në forma tabelare.

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

Komuna e Prishtines - Bartja nga viti 2025 ne vitin 2026

Pagat dhe shtesat		Buxheti
1	94350 - ARSIMI I MESHËM I LARTË	60,000.00
TOTALI PAGAT DHE SHITESAT		60,000.00

Mallrat dhe shërbimet		Buxheti
1	16306 - ADMINISTRATA-PRISHTINE	674,044.11
2	18040 - INVESTIMET KAPITALE DHE MENAXHIMI I KONTRATAVE	150,000.00
3	18166 - INFRASTRUK.PUBLIKE-PRISHTINE	4,298,924.07
4	73350 - SHËR. E KU. PRI. SHË.PRISHTINË	243,000.00
5	75526 - SHËRBIMET SOCIALE PRISHTINË	226,901.81
6	92310 - ARSIMI PARAFI & QERDH-PRISHTIN	967,338.89
TOTALI MALLRA DHE SHERBIME		6,560,208.88

Projektet kapitale		Kodi pro.	Buxheti
16306 - Administrata - Prishtinë			
1	FURNIZIMI ME PAISJE TE IT-SE PER NEVOJAT E KOMUNES SE PRISHTINES	49653	150,000.00
2	BLERJA E VETURES ZYRTARE	I ri	19,000.00
TOTALI KAPITALET			169,000.00

18039 - Shërbimet publike			
1	Ndertimi i parkut ne lagjen "Kalabria" faza III	54454	74,462.50
TOTALI KAPITALET			74,462.50

18040 - Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave			
1	Rrethrotullimi Lakrishte - Rrethrotullimi Arberi	43194	123,297.18
2	NDERTIMI I URAVE NE PJESEN PERENDIMORE TE UNAZES QENDORE-LAK	52555	472,209.10
3	NDERTIMI I RR."BAJRAM BAHTIRI"	53939	1,363,636.45
4	Ndertimi i Kolektorit ne Hajvali	51714	303,904.60
5	Sanim ne hidroizolim, termoizolim te Pallati i rinise	I ri	55,165.15
6	Ndertimi i rrugeve ne Bardhosh - Bernice	56467	134,769.29
TOTALI KAPITALET			2,452,981.77

18166 - Infrastruktura Publike - Prishtinë			
1	Ndertimi i rrethojave per varreza ne Komunen e Prishtines	56490	260,000.00
2	NDERTIMI DHE REKONSTRUIMI I PRITOREVE TE AUTOBUSAVE, BANKAVE	53589	200,000.00
3	Ndertimi rrethojave per siguri ne komunikacion Zona1: Qendra- Tophane,Dodona,Bregu i Diellit,Ulpiana, Dardania, Lakrishte dhe Zona 2:Kodra e	52509	250,000.00
TOTALI KAPITALET			710,000.00

85086 - Sporti dhe rekreacioni - Prishtinë			
1	NDERTIMI I TRIBUNES "FLAMURTARI"	53986	135,060.00
2	Ndertimi i fitneseve,natyra ne parqe dhe kende strategjike te Prishtines - Lagjia Kodra e Trimave	54442	150,000.00
TOTALI KAPITALET			285,060.00

93150 - Arsimi fillor, i mesëm i ulët			
1	Renovimi i shkollave fillore : Asim Vokshi,Zenel Hajdini,Nazim Gafurri,Nexhmi Mustafa,Isa Boletini,Dituria	53600	500,000.00
TOTALI KAPITALET			500,000.00

TOTALI I KAPITALEVE NGA BARTJA			4,191,504.27
--------------------------------	--	--	--------------

KATEGORITE EKONOMIKE			Buxheti
1	TOTALI PAGA DHE SHTESA	11	60,000.00
2	TOTALI MALLRA DHE SHERBIME	13	6,560,208.88
3	TOTALI KAPITALE	30	4,191,504.27
TOTALI I BARTJES SE MJETEVE			10,811,713.15

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina

.....



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

REFERENCË:	Nr.
DATË:	12.05.2026
PËR/ZA/TO:	Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës Fehmi Kupina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshme në MAPL Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së
CC	
NGA/OD/FROM:	Drin Haraçia, Drejtor i Departamentit për Mbikëqyrje dhe Përformanc Lokale Kujtim Aliu, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Legjislacionit Lokal Kushtrim Osmani, Zyrtar i Lart për Monitorim të Legjislacionit Lokal
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresë ligjore

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka monitoruar mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, të mbajtur më 28.04.2026. Gjatë monitorimit të mbledhjes, MAPL ka konstatuar se në pikën 9 të rendit të ditës nuk ka pasur kuorum për miratimin e kësaj pike, edhe pse Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës e ka hedhur atë në votim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në kompetencat dhe mandatin ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, konstaton si në vijim:

- Nga monitorimi i mbledhjes rezulton se, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur më 28.04.2026, Kryesuesi i Kuvendit e ka hedhur në votim pikën 9-të të rendit të ditës, e cila ka rezultuar me 21 (njëzet e një) vota për, 1 (një) votë kundër dhe 1 (një) abstenim, duke konstatuar se pika është miratuar. Ndërkaq, në sallë kanë qenë të pranishëm 23 (njëzet e tre) anëtarë të Kuvendit Komunal.
- Bazuar në nenin 46, paragrafët 46.1 dhe 46.2, si dhe nenin 48, paragrafët 48.2 dhe 48.3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij përbëhet nga së paku gjysma e numrit të

anëtarëve të Kuvendit Komunal. Po ashtu, kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë.

- Neni 48.2 përcakton se, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, vendimet e Kuvendit të Komunës aprovohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Ndërsa neni 48.3 përcakton se abstenimet regjistrohen për qëllim të verifikimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatin e votimit.

Në këtë drejtim, MAPL vlerëson se është shkelur procedura e përcaktuar me nenin 46 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, pasi që nuk është konstatuar kuorumi gjatë votimit të pikës 9 të rendit të ditës: "Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026".

Po ashtu, MAPL konsideron se është shkelur edhe procedura e votimit e përcaktuar në nenin 48 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për shkak të hedhjes në votim të pikës së lartcekur në kundërshtim me dispozitat procedurale të ligjit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve.

Në këtë kontekst, vlerësohet se vendimi i marrë mbi bazën e kësaj pike të rendit të ditës nuk përmbush standardet e kërkuara të ligjshmërisë procedurale dhe, si i tillë, cenon vlefshmërinë juridike të aktit.

Bazuar në sa më sipër, MAPL kërkon nga organet e Komunës së Prishtinës që të ndër marrin veprimet e nevojshme për anulimin e vendimit: "**Propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026**", si dhe të sigurojnë që aktet e miratuara në kundërshtim me procedurat ligjore të mos zbatohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

MAPL mbetet e gatshme të ofrojë mbështetje profesionale me qëllim të sigurimit të zbatimit të plotë dhe të drejtë të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale.

Me respekt,